

Çdo faturë e energjisë elektrike duhet të përmbajë minimalisht:

- Të dhënat teknike mbi pikën e lidhjes;
- Të dhëna identifikuese të Klientit;
- Data e leximit;
- Periudha e faturuar;
- Leximi i matësit dhe konsumi përkatës për periudhën e faturuar;
- Çmimi për njësi sipas strukturës së tarifave dhe përbërësit e tij; [2]
- Shuma në lekë që i korrespondon periudhës së faturimit; [2]
- Shumat e taksave që i korrespondojnë sipas legjislacionit në fuqi;
- Data limit e pagimit të faturës;
- Kamatëvonesa e aplikuar për çdo ditë vonesë;
- Penalitetet e mundshme për pagesë të vonuar; [2] Vlera e detajuar e debisë së Klientit;
- Informacione të nevojshme për Kujdesin ndaj Klientit (përfshirë website i kompanisë, numrat e telefonit, e-mail për ankesat, për defektet si dhe të ERE).

Furnizuesi do të sigurojë pa pagese aksesin online të faturës së energjisë elektrike për çdo Klient, duke garantuar konfidencialitetin e të dhënave të Klientit dhe faturimit.